



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. **DPK** Nr. Prot. **03-03/1026/17**
Dep. **DPK** Br. Prot. **03-03/1026/17**
Nr. Lfaq. **02** Prot. No. **14-04-2017**
Broj stranica **02** Datum **14-04-2017**
Nr. pages **02** Date **14-04-2017**
PRISHTINE

DATË/A:	14/04/2017
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z. Bedri OBERTICA Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Fushë Kosovës
CC:	z. Burim BERISHA Kryetar në Komunën e Fushë Kosovës
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Larja e Automjeteve Zyrtare "

I nderuari z. Obertica,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin "**Larja e Automjeteve Zyrtare**" me numër prokurimi: 612 17 033 236, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin "**Larja e Automjeteve Zyrtare**" me numër prokurimi: 612 17 033 236, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04/L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsyetimi

Komuna e Fushë Kosovës, përmes zyrës së prokurimit ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull " **Larja e automjeteve zyrtare** " me numër prokurimi: 612 17 023 236 i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.07/04/2017. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në fushën e Prokurimit Publik (DPKPP) sipas detyrës zyrtare ka identifikuar dhe trajtuar këtë procedurë të prokurimit. Gjatë shqyrtimit dhe ekzaminimit të dokumenteve të dosjes së këtij tenderi, AKK ka hasur në disa dhëna të cilat nuk janë në pajtim me Legjislacionin në fuqi për Prokurimin Publik.

Në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit e cila është përgatitur nga ana e Autoritetit Kontraktues, tek rubrika III.2.4) Kapacitetet teknike dhe profesionale pika c është kërkuar: OE duhet të ketë 4 kabina për automjete, të ketë bunar, të posedoj parking të mjaftueshëm dhe të ketë autolarjen jo më larg se 5km nga objekti i Komunës, dëshmia e kërkuar dokumentare: c. OE duhet të ofroj dëshmi me foto për kërkesat në pikën c. Kërkesë kjo për të cilën Agjencia konsideron se është diskriminuese dhe kufizon konkurrencën e lire në mesin e Operatorëve Ekonomik.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Fushë Kosovës me formulimin e kësaj kërkesë në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit ka bërë Diskriminim territorial në kundërshtim me ligjin në fuqi për Prokurim Publik ku thuhet se Autoriteti Kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik, duke diskriminuar Operatorët Ekonomik që janë në largësi më tepër se 5km dhe duke favorizuar Operatorët Ekonomik që janë me afër se 5 km.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe për përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar Operatorët të cilët e kanë tërhequr materialin tenderik.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !